



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9940/1 Prot.

Roskovec, më 24.12.2024

Procesverbal Nr.13

-I mbajtur sot, datë 23.12.2024, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Nëntor 2024.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Nëntor 2024.
5. Për miratimin e Bursave të shtetit për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike për vitin shkollor 2024-2025.
6. Për bashkimin e Ndërmarrjeve vartëse të Bashkisë Roskovec në një njësi shpenzuese me emërtim "Ndërmarrja e Shërbimeve Publike" Bashkia Roskovec.
7. Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse.
8. Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025.
9. Për miratimin e kalendarit të Menaxhimit Buxhetor për vitin 2025.
10. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁰

Këshilltarët prezent: A.Plaka, A.Lamaj, E.Çepele, Rr.Hazizi, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, Zh.Metushi, N.Zeka, H.Hajdini, E.Xhaxhaj, Dh.Malka, A.Hoxha, A.Pelo, S.Bibo Qamili, F.Feleqi, P.Toro, E.Kaçeli, E.Toska.

Këshilltarët që mungojnë: J.Begaj, V.Çepele.

Prezent nga bashkia: Kryetarja e bashkisë M.Bufi, Nënkryetari M.Goga, Dr.Ekonomik S.Çepele, Dr.Juridik V.Zeqo, P/Shërbimit Social S.Saliaj, Dr.Qendrës Ekonomike Arsimore M.Zoga. Prezent Kryetarët e fshatrave si dhe qytetarë.

Me plotësimin e kuoromit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 16 këshilltar. Kryetari – faleminderit të nderuar këshilltar që jeni bërë pjesë e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Roskovec të datës 23.12.2024, mbledhja e fundit e parashikuar për këtë vit kalendarik.

Do doja tju falenderoj dhe për prezencën tuaj në gjithë mbledhjet e deritanishme. Gjithashtu faleminderit Kryetare e Bashkisë për praninë tuaj në këtë mbledhje, si dhe falenderoj dhe gjithë qytetarët që kanë zgjedhur të marrin pjesë si dëgjues në këtë mbledhje të fundit të Këshillit Bashkiak Roskovec. Të nderuar këshilltar, ashtu sikundër jam përpjekur tju njoftojë paraprakisht, në Sekretarinë e Këshillit kanë ardhur si nevojë për tu diskutuar dhe më tej miratuar në këtë mbledhje dy projekt-vendime, të cilat fakti që ne jemi përpara mbledhjes së fundit na detyron për tju sjellë përpara jush, për tu diskutuar dhe për tu futur në rendin e ditës të kësaj mbledhje. Projekt-vendimi i parë ka të bëjë me miratimin e ndihmës nga fondi i kushtëzuar për djegien e banesës së një qytetari të Bashkisë Roskovec Barjam Shehu. Ashtu sikundër ju kam sqaruar ky është një fond i cili duhet trajtuar brenda periudhës kohore të këtij viti. Gjithashtu një projekt-vendim tjetër i cili ka ardhur për tu shtuar në rendin e ditës sotme me të cilin jeni njohur në datën 18.12.2024 është projekt-vendimi në mbështetje të një Vendimi të Këshillit të Ministrave, i cili ka ardhur në bashki një ditë pas mbledhjes së Kryesisë dhe pas miratimit të rendit të ditës me të cilin ju jeni njohur, dhe ka të bëjë pikërisht me një akordim fondesh i bërë nga qeveria shqiptare për Bashkinë Roskovec. Që ky fond të bëhet i mundur për lëvrimin e tij, duhet që nga ky Këshill i nderuar të miratohet si shtesë fondesh, pra të pranohet si shtesë fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec, në mënyrë që më pas të bëhet i lëvrueshëm. Kërkon dikush fjalën? Fredi-unë sa i përketë fatkeqësisë natyrore jam shumë dakort, e kam shprehur dhe në grup por ka një problem sepse mesa kam unë informacion nuk është i vetmi person që ka patur fatkeqësi natyrore, dhe jo dyshoj por ne jemi plotësisht dakort të vihen disa, në qoftë se kanë qënë tre veta të vihen të tre, ai fond të vihet në dispozicion për të tre, sepse po filluan seleksionimet të gjykojmë edhe popullin por edhe nevojat e tij, me një kusht që të vihen të tre ata që janë prekur nga fatkeqësi natyrore. Në qoftë se nuk vihen dhe pastaj ka seleksionime, vihet vetëm ai person pastaj ne nuk jemi dakort. Kurse për pikën tjetër jemi plotësisht dakort sepse e dimë dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave dhe jemi plotësisht dakort për mos të humbur fondin. Në këtë moment vjen këshilltarja P.Toro. Prezent tani në sallë 17 këshilltar. Kryetari- faleminderit z.Fredi. Diskutimi ishte në fakt përse i takon rendit të ditës, kurse në qoftë se do ti futemi projekt-vendimit për diskutim është çështje që mund ta diskutojmë kur të vij radha e diskutimit të atij projekt-vendimi. Ky është mendimi dhe sugjerimi im, megjithëatë znj. Kryetare ka kërkuar fjalën për të sqaruar diçka në lidhje me këtë. Kryetarja M.Bufi-e para dua tju bëj me dije që procedura e dëmshpërblimit është një procedurë ligjore, dhe ka ca rregulla dhe ca standarte të cilat ne si zbatues jemi të detyruar vetëm ti zbatojmë, dhe çdo dëmshpërblim jepet pasi ka një kërkesë të atij që i ka ndodhur dëmi, dhe sipas kërkesës që duhet të vij zyrtarisht në bashki brenda një afati 5 ditor, ngrihet grupi i punës dhe bën vlerësimet e dëmit. Në asnjë rast ne nuk kemi patur kërkesë për dëmshpërblim me shkrim, dhe në informacionet që ne kemi zyrtare, zjarret e rëna në territorin e Roskovecit në shumicën e rasteve kanë qënë në fusha të hapura, ku mund të jenë djegur pemë, barishte. Ka disa raste kur ka ndodhur në banesa ose në kasolle. Sipas informacionit që kam nga sektori i zjarrfikses dhe policia e rendit, ka një rast që ka rënë në 25.06.2024 në fshatin Kurjan z.Përparim Patozi, nuk ka bërë kërkesë për dëmshpërblim. Ka një rast tjetër në 23.07.2024 në fshatin Drizë, banesa e z.Adrian Hoxha, ka paraqitur kërkesë por nuk është banor i Roskovecit, është banor i bashkisë Patos. Fredi- është tjetër gjë banor, taksat ku i paguan? Kryetarja M.Bufi-të lutem, me gjëndje civile, nuk e ka gjëndjen civile në Roskovec. Ka një rast tjetër të ndodhur në 3.10.2024 në banesën e z.Bani Prifti në Marinëz, nuk ka bërë kërkesë dhe kërkesa e vetme që është paraqitur është kjo që ka ndodhur në banesën e z.Barjam Shehu në Roskovec. Ka një kërkesë me shkrim, është paraqitur i biri ka bërë

kërkesën me shkrim brenda 5 ditëve siç e thotë ligji, sepse nuk mundesh që sot të bësh kërkesë me shkrim kur zjarri mund të ketë ndodhur para 3 muajve, 6 muajve dhe të bësh vlerësimin e dëmit dhe kur ti nuk ke më asnjë gjurmë të asaj që ka ndodhur. Pra ka një afat zyrtar që e parashikon ligji, afat kohor për vlerësimin e dëmeve, por sigurisht dhe atje ku ndodh dëmi duhet të ketë një kërkesë me shkrim për dëmshperblim. Kjo është situata, kërkesa e vetme që është paraqitur brenda afateve zyrtare, është ngritur grupi i punës ka bërë vlerësimin e dëmit dhe e kemi paraqitur për miratim, e cila erdhi ndoshta jashtë afatit por që ua ka shpjeguar Kryetari i Këshillit, nëse nuk doni ta miratojmë e lëm ska asnjë lloj problemi. Dhurata-mund të bëj një pyetje? Kryetari-znj.Dhurata po ju mund të bëni një pyetje, por do ju lutem shumë që mos ta trajtojmë si diskutim, mos ta ezaurojmë tani, në qoftë se doni mund ta diskutojmë gjatë dhe gjerë..Dhurata-shkurt do ti bie edhe unë, do ti thoja Kryetares që personi në fjalë erdhi bëri kërkesë me shkrim sepse ishte vënë në dijeni, tani ju si Kryetare, si bashki ku e morët vesh që janë dëmtuar dhe 3 a 4 familje të tjera, kur ata spatën mundësi të bënin ankesë me shkrim, nga e zbuluat? Kryetarja M.Bufi-tani kjo nuk është kërkesë për procedurë. Dhurata-ok,por nga e zbulove? Kryetarja M.Bufi-të lutem Kryetar, nëse e vazhdojmë diskutimin në këtë mënyrë..Dhurata-po jo se kam raste dhe në Suk, se sollët zjarrfiksen dhe nuk u morr parasysh, këtu e kam. Kryetari- po futeni në diskutime znj.Dhurata të cilat me siguri janë të mirëpritura në momentin e diskutimit të këtij projekt-vendimi por për procedurë nuk mund ta ezaurojmë të gjithë këtë pikë të rendit të ditës pa u miratuar, dhe ta ezaurojmë deri në fund, megjithëatë Kryetare do ju lutesha nëse keni një përgjigje të shkurtër, që të vazhdojmë me procedurën e mbledhjes. Kryetarja M.Bufi-ka një procedurë përsëri ligjore që çdo strukturë e cila me ligj përgjigjet për dëmet që ndodhin, qoftë zjarrvëniet apo diçka tjetër si tragjedi natyrore, edhe policia e rendit dhe sektori i zjarrfikses është i detyruar të sjelli informacion me shkrim për çdo rast që ndodh, në bashki për Kryetarin e bashkisë.Përcjell një informacion për orën, për vendndodhjen, për ngjarjen që ka ndodhur, kur ka ndodhur dhe ky informacion me shkrim i përcillet Drejtorisë së Policisë Fier. Pra ka një informacion zyrtar e nderuar këshilltare, që vjen me shkrim siç vjen me shkrim nga sektori përkatës që e ka detyrim ligjor këtë gjë, ashtu edhe qytetarët duhet të bëjnë një kërkesë me shkrim në sistem pranë bashkisë, dhe kërkesat e tyre merren në konsideratë, vlerësohet nga grupi i punës dhe nga sektori që e ka detyrim ligjor të bëj këtë lloj vlerësimi, dhe pastaj materialet i sillen Këshillit për vendimmarrje.

1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari- për procedurë duhet tju pyes dhe të hedh në votim rendin e ditës me dy ndryshime, me shtesën e dy projekt-vendimeve si më sipër “Për miratimin e ndihmës nga fondi i kushtëzuar për djegien e banesës së Barjam Shehu, Bashkia Roskovec për vitin 2024” dhe “Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024”.Kryetari hedh në votim rendin e ditës me shtesat e bëra si më sipër dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Nëntor 2024.

Sekretarja sqaron informacionin në lidhje me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar, dy vendimet normative të cilat janë dërguar në Prefekturë dhe janë konfirmuar nga Prefektura. Të gjitha vendimet u janë shpërndarë zyrove përkatëse për zbatim. Në këtë moment vijjnë këshilltaret E.Kaçeli dhe E.Toska.Prezent tani në sallë 19 këshilltar.

3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 19 vota pro.

4.Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-30 Nëntor 2024.

P/Shërbimit Social Sidorela sqaron projekt-vendimin sipas materjalit.Amarildo-këtë e kemi parë se janë të njëjtët ata që trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6%, por unë do kisha një sugjerim, meqënëse jemi në muaj festash për pak janë Krishtlindjet dhe Viti i Ri, a ka mundësi, brenda mundësive bashkia tu akordojë këtyre familjeve që janë në nevojë një shpërblim modest? Leksi- është përfshirë në vendimin e qeverisë dhënia e shpërblimit? Sidorela-akoma nuk ka ardhur me vendim. Kryetarja M.Bufi-besoj do të ndodh se çdo vit ka ndodhur, çdo qeveri e ka dhënë pavarësisht ngjyrave politike. Është një kategori qytetarësh, familjesh që e kanë të nevojshme dhe padyshim do ta marrin këtë gjë, bonusin e Vitit të Ri. Në momentin që qeveria do marrë vendim padyshim do ta shpërndajë për gjithë kategorinë e familjeve në nevojë që janë pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike, invalidët por edhe ne si bashki kemi dhënë çdo vit paketa ushqimore, jo vlerë financiare por paketa ushqimore. Besoj edhe këtë vit do të shpërndajmë për të gjithë ato familje, edhe me informacionet që na sjellin Kryetarët e fshatrave, por edhe në ato familje që vijnë bëjnë kërkesë, që ne i njohim, padyshim dhe ata do ti trajtojmë por me paketa ushqimore, jo me masë financiare nga bashkia sepse është e pamundur. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin dhe miratohet unanimitisht me 19 vota pro.

5.Për miratimin e Bursave të shtetit për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike për vitin shkollor 2024-2025.

Dr.Qendrës Ekonomike Arsimore Marinela shpjegon projekt-vendimin.Gjithësej na kanë ardhur 15 kërkesa nga nxënësit e vitit të parë të shkollës së mesme profesionale Rakip Kryeziu dhe Petro Sota Fier. Dhurata-ka ndonjë kriter? për informacion se ne normalisht që do jemi pro. Marinela-të gjitha kërkesat që na janë paraqitur, i kemi përfshirë të gjitha. Kryetarja M.Bufi-ose më saktë pyetja ime është kjo, ka ndonjë kërkesë që nuk është miratuar? Marinela-jo nuk ka. Maksi-janë më shumë bursa se kërkesa. Fredi-mbase ska qënë sensibilizimi. Dhurata-mbase është prioriteti i qeverisë që ti afrojë më shumë të rinjtë drejt arsimit profesional, por do thoja sa prej tyre janë në gjendje të mirë ekonomike, dhe këtë mund tja jepnit dikujt tjetër, një familje që ka nevojë për ndihmë vërtetë. Kryetarja M.Bufi-ne kemi trajtuar çdo lloj kërkesë që ka ardhur. Dhurata-të paktën mesa njoh unë në zonën time njëri që i ka prindërit e divorcuar por është mirë ekonomisht, por gjithsesi..Kryetarja M.Bufi-ne kemi plotësuar çdo lloj kërkesë që ka ardhur, pavarësisht nivelit ekonomik, edhe ata që mund të jenë në gjendje të mirë ekonomike edhe ata që nuk janë se përderisa bursa është, shteti e jep pse mos ta marrë.Ne nuk dimë të ketë kërkesë dhe ne mos ta kemi marr në konsideratë. Marinela-të gjitha kërkesat janë marr në konsideratë, kanë plotësuar edhe kriteret. Elizabeta Kaçeli-unë si Kryetare e Komisionit të Arsimit dhe Kulturës e konsultuam edhe me z.Gogo në bisedë telefonike, dhe e pamë të arsyeshme që nuk ishte e nevojshme për tu mbledhur komisioni, për shkak se oferta ishte më e madhe dhe kërkesa më e ulët, kështu që për të gjithë emrat që ishin në listë ne jemi dakort, prandaj ne nuk u mbledhem në ambjent fizik, por u

morrëm vesh online sepse edhe kjo është e parashikuar në ligj. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit dhe miratohet unanimitisht me 19 vota pro.

6. Për bashkimin e Ndërmarrjeve vartëse të Bashkisë Roskovec në një njësi shpenzuese me emërtim “Ndërmarrja e Shërbimeve Publike” Bashkia Roskovec.

Dr. Juridike Vjollca-ky projekt-vendim vjen si rezultat të manualeve orientuese që janë hartuar nga qeveria shqiptare në bashkëpunim me AMVV-në, dhe referuar manualeve për Bashkinë Roskovec që është deri në 50 mijë banor, ne kemi përgatitur materjalin për bashkimin e këtyre ndërmarrjeve. Duke qënë se sipas këtij materjali do funksionojnë aparati dhe funksioni si dhe shërbimet, në Bashkinë Roskovec do qëndrojnë aparati që ka të bëjë me natyrën politikbërëse, rregullatore dhe monitoruese, funksionet janë funksione që janë të patransferueshme dhe do të jenë nga vet bashkia, këtu përfshihet Mbrojtja Civile, MZSH-ja, Policia Bashkiake, Gjendja Civile etj. Gjithashtu dhe shërbimet që janë të transferueshme, këto do të bashkohen nëpërmjet një Nipti të përbashkët që është Nipti aktual i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale dhe do të funksionoj më vete. Kjo bëhet për unifikimin e të gjitha strukturave në Republikën e Shqipërisë, që tashmë ka filluar edhe në bashkitë e tjera të vendit. Ky proces do realizohet me bashkimin e tre ndërmarrjeve aktuale, Ndërmarrjes së Pyjeve, Ujitjes e Kullimit dhe Mirëmbajtje Rruge e Varreza, Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Mjedisit dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale, ndërsa sa i përket Qendrës Ekonomike Arsimore duke qënë se në këtë qendër janë funksionet, një pjesë e tyre do të kalojnë sistemi arsimor parashkollor në bashki, ndërsa pjesa tjetër rojet dhe sanitaret do të kalojnë tek ndërmarrja e re që do të krijohet. Për këtë arsye kemi paraqitur këtë projekt-vendim për miratim. Dhurata-zonja i tha por si e paqartë, se nëse i referohemi këtyre pikave që janë radhë këtu, se këtu thotë pika 1,2,3,4,5,6 e me radhë. Pika 1 thotë bashkimin e Ndërmarrjes së Pyjeve një, Ujitjes e Kullimit dhe Mirëmbajtje Rruge e Varreza dy, Ndërmarrjes së Mirëmbajtjes së Mjedisit tre, Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale katër, të gjitha këto të katërta mblidhen në një? Vjollca-po do mblidhen në një. Qendra Ekonomike Arsimore ka një specifik sepse ka funksione brenda, ka sistemin arsimor parashkollor dhe edukatoren e çerdhes, kopshteve do kalojnë në bashki, ndërsa pjesa tjetër që janë roje, sanitare.. Dhurata-pse nuk janë në bashki ato, këto në bashki kanë qënë. Vjollca-jo, janë tek Qendra Ekonomike Arsimore që është funksion vartës i Bashkisë Roskovec. Dhurata-po pse do ndahen punonjësit, për cilën arsye? Vjollca-sepse sipas manualit orientues që ka ardhur i hartuar nga AMMV-ja, ndahet aparati më vete që është shërbimi civil, funksionet më vete dhe shërbimet më vete. Shërbimet aktualisht po mblidhen në një institucion vartës, që aktualisht ne i kemi katër, do bëhet në një dhe do funksionojë me Niptin aktual që ka Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale. Thjesht është çështje riorganizimi, unifikimi, nuk ka ristrukturim në ikjen e punonjësve, numri aktual është 393 dhe do të jetë 395. Fredi-sa është numri i punonjësve? Vjollca-aktual është 393 bashkia bashkë me institucionet vartëse. Fredi-e shikoni znj. Kryetare që më ke thënë, e ke nga zonja. Kryetarja M. Bufi- edhe moralisht por edhe në përgjigje të asaj që thatë, më takon që ta jap një shpjegim. Besoj se Dr. Juridike u shpreh qartë në arsyet se pse po bëhet kjo gjë, ka një manual nga Ministria e Pushtetit Lokal, ajo AMVV-ja që përmendi Vjollca është Agjencia për Mbështetjen e Pushtetit Vendor, janë dy struktura që punojnë së bashku në mbështetje të pushtetit lokal, dhe këto dy institucione kanë krijuar një manual i cili ka bërë, ka lidhur funksionet njëri me tjetrin, ka lidhur qëllimin e çdo pozicioni dhe ka bërë organizimin e tyre, dhe këtë manual

ua ka sjellë për zbatim të gjitha bashkive të territorit, në mënyrë që të gjitha funksionet që janë pavarësisht vendit ose faktit se ku punon, po themi një jurist, një punonjës i policisë bashkiake, një zjarrfikës të jetë i orientuar ekzaktesisht në të njëjtën terminologji në çdo bashki. Për të bërë këtë lloj organizimi na është sjellë ky manual, e kemi marr, e kemi diskutuar, efektet nuk janë me rritje financiare sepse do ta shpjegojë unë pse është ashtu, sa ishte numri i punonjësve të bashkisë më përpara? Vjollca-më përpara 393 tani do jetë 395, vetëm 2 shtesa. Kryetarja M.Bufi- dhe këta 2 punonjës nuk janë shtesë për shkak të ristrukturimit, por nëse ju kujtohet në mbledhjen e kaluar kemi shtuar 7 punonjës, të cilët janë punonjës me kontratë dhe kanë një qëllim të caktuar dhe një projekt të dedikuar se pse janë marr, dhe në qoftë se nuk do kishit marr vendimin e kaluar që u shtuan 7 punonjës, ne do kishim 5 punonjës më pak tani i nderuar këshilltar dhe jo 2 më shumë, por megjithatë ky ristrukturim që është bërë ka vetëm një qëllim, organizimin më të mirë të punonjësve që punojnë me shërbime në terren, që kanë të bëjnë me ujitjen, me kullimin, me pastrimin, gjelbërimin, mirëmbajtjen dhe gjithçka tjetër ka të nevojshme një territor i caktuar, një bashki pavarësisht sesi e ka emërtimin, dhe të gjitha ato pozicione që janë pjesë e nënpunësit civil dhe kanë të bëjnë me statusin e nënpunësit civil brenda administratës së bashkisë. Pra për ti riorganizuar më mirë të gjithë funksionet, dhe duke marr parasysh faktin që rritja e pagave që u miratua në Shtator e bën të detyrueshme riorganizimin në këtë lloj mënyre të strukturës së bashkisë. Kjo është gjëja dhe ky është qëllimi se pse është bërë kjo. Fredi-e para znj.Kryetare, që e ndërpreva zonjën, më fal znj.punonjëse, i thashë përsërite sepse për numrin e punonjësve dy mbledhje para kësaj mbledhje, jua kam përmendur që numrin e punonjësve e keni 387 dhe ju keni thënë gënjen, në mbledhje. Me numrin që e tha zonja 393, atëherë i bie që gënjeni juve dhe duhet të kërkonit falje, e para mua. E dyta, ju vjet para 1 viti kërkuat ristrukturimin e ndërmarrjeve dhe i ndatë ndërmarrjet, me konkluzionet tuaja, justifikimet tuaja. Nuk kemi asnjë gjë për mënyrën e organizimit dhe të gjitha, por vit për vit e kupton? Mbledhjen e parë kërkuat rritjen e numrit të punonjësve, ndarjen e numrit, këtë radhë po kërkonit, vet veprimet tuaja lënë për të dyshuar, për këtë e kishim, por ska asnjë gjë në qoftë se nuk ka efekte financiare absolutisht jemi dakort, por vet veprimet tuaja lënë për të dëshiruar dhe lënë për të dyshuar. Kryetarja M.Bufi-një gjë dua të them publikisht sepse jemi online dhe të gjithë na dëgjojnë, cilido këshilltar që ka një dyshim për një vendimarrje ose veprim të caktuar nga ana e bashkisë, ai vendi i kërkesave me shkrim është aty, i hapur për të gjithë dhe kushdo që ka bërë një kërkesë me shkrim për marrje informacioni, dokumenti, e ka marr përgjigjen dhe do ta marr përgjigjen. Pastaj atë letrën që ju japim ne për çdo informacion që kërkonit, ju e merrni e vlerësoni është e drejta juaj, ne këtu jemi të gjithë të hapur publikisht për ato që themi gjithsecili prej nesh. Por edhe një gjë tjetër dua të them, që çdo lloj projekt-vendimi që ju sjellim, i krahasueshëm me ato që mund të kenë qënë të ngjashme një vit më parë, kanë vetëm një qëllim, përmirësimin e punës dhe organizimin e gjithçkaje në mënyrë që gjëja nga njëri vit në tjetrin, të bëhet më i mirë organizuar për dhënien e shërbimeve më të mirë qytetarëve. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 14 vota pro, 5 vota abstenim Dh.Malka,E.Xhaxhaj,F.Feleqi,A.Hoxha,A.Pelo. Miratohet.

7.Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse.

Dr.Juridike Vjollca-të nderuar këshilltar, ju kemi paraqitur për miratim nivelin e pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe Ndërmarrjes vartëse. Kjo është thjesht proceduriale sepse

pagat ju tashmë i keni miratuar në Shtator të këtij viti, nuk do të ketë ndryshime janë të njëjta, thjesht janë ndarë tani me lidhje duke qënë se do jenë Bashkia dhe një ndërmarrje që është Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. I keni të kategorizuara sipas pozicionit për Bashkinë Roskovec dhe për funksionet, me shtesa, vjetërsi dhe paga bazë që do ketë çdo pozicion. Ju ftoj ta miratoni këtë projekt-vendim. Kryetarja M. Bufi-niveli i pagave për punonjësit me arsim të mesëm dhe punonjësit që punojnë në terren, në shërbime që janë me arsim të mesëm ose 8 apo 9 vjeçar, ende nuk ka një vendim, janë vetëm ato nivele që ishin. Në fakt jemi duke pritur një vendim të qeverisë, që është duke u diskutuar, nuk është zbardhur, nuk ka ardhur për zbatim. Në momentin që do vij për zbatim ky vendim që prek dhe afekton rritjen e pagave për gjithë punonjësit e bashkisë me arsim të mesëm, që mund të punojnë në pozicione të tilla si topograf i mesëm, sanitar, shofer, apo polic bashkie që janë me arsim të mesëm, sot nuk janë afektuar, presim vendimin e qeverisë, dhe e njëjta gjë funksionon edhe për punonjësit e terrenit që mund të jenë punëtor shërbimi, pastrimi, gjelbërimi. Në momentin që do vij ne menjëherë do të përpiqemi që ta plotësojmë dhe këtë gjë. Është kategoria që realisht sot ka nevojë për këtë rritje. Fredi- për sqarim, me vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave që u vu në shqyrtim dhe ne e miratuar në mbledhje për rritjen e pagave, a nuk kishte vend për punonjësit me pagë minimale që thatë ju? këta përjashtoheshin me vendim? Kryetarja M. Bufi-po pikërisht pra, ai vendim qeverie nuk i prekte fare punonjësit me arsim të mesëm dhe ata që janë në nivelin e shërbimit, prekte vetëm kategorinë e shërbimit civil dhe prandaj unë u shpreha paraprakisht dhe mora fjalën, që është nevoja dhe koha që kjo kategori e punonjësve me arsim të mesëm dhe me nivelin më të ulët, të kenë dhe të marrin rritjen që duhet bërë. Ne po presim vendimin e qeverisë për këtë gjë. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit dhe miratohet me 14 vota pro, 5 vota kundër Dh. Malka, E. Xhaxhaj, F. Feleqi, A. Hoxha, A. Pelo. Miratohet.

8. Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe Buxhetit të vitit 2025.

Kryetari- siç e keni vënë re PBA-ja përfundimtare dhe buxheti i vitit 2025 janë të përfshira në një projekt-vendim, në bazë dhe të këshillimeve të marra nga zyra juridike e Prefekturës, duke qënë se këto janë dy dokumenta të lidhura me njëri-tjetrin, janë të përfshira të dyja në të njëjtin projekt-vendim. Dr. Ekonomik Selmani- të nderuar këshilltar ju paraqesim këtë projekt-vendim që është nga vendimmarrjet e fundit por nga më të rëndësishmit e çdo viti buxhetor, kjo si rrjedhojë e një pune të bërë gjatë gjithë këtij viti, me katër vendimmarrje paraardhëse se kjo është e pesta, e cila konsolidon më në fund PBA 2025-2027 dhe buxhetin e vitit 2025 i cili është viti i parë i kësaj PBA-je. Në vazhdim të punës së kryer në këtë vendimmarrje nuk u kemi paraqitur ndryshim përse i takon nivelit të fondeve të ndarjeve në mënyrë funksionale, siç janë për paga dhe sigurime, për operative dhe investime, i jemi përmbajtur atyre niveleve të vendimmarrjes së muajit Shtator, me përjashtim të shtesës së fondit për përbalimin e rritjes së pagës së administratës, i cili përballohet nga qeverisja qendrore, i cili në krahasim me atë vendimmarrje që ne kemi marr në Shtator ishte gati 21-22 milion lekë më shumë, i cili u pasqyrua pastaj në këtë dokument që ne ju paraqesim sot. Unë nuk kam se çfarë tju sqaroj, përveç pyetjeve apo sqarimeve që do të kërkonte, sepse ky materjal është nga më voluminozët, të paktën ne si administratë paraqesim dhe ndoshta me të drejtë sepse ka të bëjë me një buxhet si 3 vjeçar ashtu dhe me buxhetin e parë të PBA-së, por në fund do tju falenderoj që me vendimmarrjen që ju keni marr, ne na keni ndihmuar padyshim në punën tonë duke na e bërë më të lehtë, dhe padyshim dhe këto mangësira që mund të kenë hasur gjatë këtij

materjali, unë jam i bindur dhe u siguroj dhe në emër të administratës së bashkisë, që do të përmirësohen dhe do të rregullohen akoma më mirë, për të paraqitur një buxhet sa më real dhe në funksion të komunitetit. Fredi-pyetje kisha për ju z.Kryetar, unë kam një muaj që kërkoj projekt-buxhetin, e kam bërë kërkesën time tek znj.Sekretare e Këshillit, projekt-buxheti është kaq (tregon materjalin),për katër ditë edhe ekselent të jesh, cila është arsyeja z.Selman se pavarsisht se znj.Sekretare e Këshillit nuk kishte se ç'a të më thoshte sepse ashtu i thoshte Selmani, të futësh mik tek Selmani për të marr projekt-buxhetin? Është një detyrim ligjor unë nuk e kuptoj pse duhet zbatuar momenti final ajo katër ditë, pesë ditë. Jam detyruar të marr Selmanin tre katër herë në telefon, në mënyrë kështu arrogante, jo me justifikime, jo me budallëqe, është turp. Kryetari-faleminderit z.këshilltar, unë jam njohur me kërkesën tuaj, e kam trajtuar dhe përcjellë këtë kërkesë. Këtu sot kemi pikërisht drejtorin dhe ai mund të na japi një shpjegim për situatën dhe arsyet pse e ka vonuar dhënien e informacionit. Selmani-sa i takon pyetjes që bëri këshilltari e thashë dhe më para dhe tani, që ne i jemi përmbajtur të gjitha niveleve dhe materjalit që ne kemi miratuar në muajin Shtator të këtij viti, dhe përveç pagave që ka ndryshuar niveli nga muaji Shtator vetëm nga financimi nga buxheti qëndror, neve gjatë këtyre ditëve kemi bërë vetëm ndarjen, në qoftë se investimet për vitin 2025 ishin në bllok, neve i ndamë me objekte dhe për të cilat ne kemi bërë dhe dëgjuesat përkatëse, dhe në bazë të dëgjësive përkatëse ne i kemi hedhur këtu në këtë buxhet dhe janë pasqyruar të gjitha këtu. Unë mendoj që nuk kishte nevojë për më shumë ditë sesa 6 apo 7 apo sa ishte tani, ndoshta kemi gabuar do të shikohen edhe në të ardhmen për ta rregulluar këtë punë, ndërsa për arrogancë unë nuk e pranoj se nuk jam përgjigjur në mënyrë arrogante por për çdo gjë jam përgjigjur. Kryetari-i kërkoj z.Drejtor që kërkesat legjitime të këshilltarëve në adresën tuaj, tju jepet përgjigje në kohën e duhur. Dhurata-unë duke iu referuar këtij materjali të paktën siç ishte voluminoz dhe i hodha një sy, e studiova me aq sa munda dhe jam ndalur tek projektet e investimeve 2024 e në vazhdim 2025, 2026 e me radhë. Konkretisht sa janë zbatuar këto projekte nga 1 Janar 2024 deri në 31 Dhjetor 2024 që jemi aktualisht? Është një kod atje 1130411 thotë atje asfaltimi i rrugës para shkollës Suk 1, kisha një pyetje lidhur me këtë, ka mbaruar ky asfaltim i kësaj rruge meqënëse është përfundimi deri në 31 Dhjetor 2024, është brenda parametrave të duhur sipas jush? Në këto projekte janë gjithashtu edhe për mbushjen me çakull të disa rrugëve, në sa rrugë rurale është hedhur çakull?sepse vazhdimisht ju caktoni fonde dhe ndërkohë se di ku janë zbatuar, ku janë hedhur këto fonde? Keni hedhur pastaj prapë fonde në 2024,2025 në vazhdimësi për kontinier dhe kosha mbeturinash, unë nuk mendoj se janë shumë...na duhen patjetër por mesa shoh të paktën çdo 2-3 km unë shoh kosha mbeturinash, por shoh që ato janë pa pastruar. Unë tani ndoshta ju kërkojë ndjesë se e hodha tek grupi i Këshillit nja dy vidio të filmuara, të paktën për zonën ku mbuloj Njësinë Administrative Strum atje ku më kanë votuar qytetarët, me dhjetra herë e kam ngritur këtë shqetësim. Po ti vini re tek vidioja që ju kam hedhur atje, rrugës së lumit ku janë pompat e ujit atje asnjëherë nuk pastrohet ose pastrohet një herë në 6 muaj. Atje pranë është një shtëpi, atje banojnë njerëz me ngjyrë dhe është shumë turp dhe është shumë keq dhe shumë gjynah që ata jetojnë në atë katastrofë, me ato mbeturina. Kryetarja M.Bufi-ku janë këta njerëz me ngjyrë? Dhurata-rrugës së pompave në Suk 1. Shikoje situatën se jo pa qëllim kam bërë vidio dje mbasdite në orën 4.30, me erdhi shumë keq kur pashë ato femra atje që ndërnin rrobat, ndërkohë mjedisi është shumë i ndotur gati 500 m deri 1 km me pisllice. Asnjëherë nuk është pastruar ka 4 muaj rresht, gjynah dhe për ata që banojnë atje pranë, se janë më afër nga të tërë 100 m larg, pastaj është familja e të ndjerit Bahir Karamani e të tjerë me radhë. Kemi një kod tjetër pastaj P72RO1 rikonstruksionin e ambulancës Suk 1 në varësi të Qendrës

Shëndetësore Strum. Unë të paktën që atje banojë dhe kalojë, ky rikonstruksion duhej të ishte bërë brenda 2024 mesa shoh, ka një kosto spo e përmend sepse e dini vet ju, ka filluar apo ka mbaruar? Kryetarja M.Bufi-thoje. Dhurata- po ju i keni vet shkresat aty, ja ke drejtorin atje, ka filluar apo ka mbaruar, mbaje shënim pyetjen. Kemi një kod tjetër P912RO1 blerje kamerash për kopshtet dhe çerdhen, kemi nja dy vjet që i kemi hedhur këto ne, mua smë interesojnë po them pse hidhen kot se skam parë kamera dhe as duhet të jenë për mendimin tim, se unë e di ç'a pune bëhet dhe si sillen edukatorët, gjithë arsimtarët. Pse ta hedhim kot atë fond pavarësisht se ka ardhur urdhëri nga lart. Kemi kodin 626R07 blerje e 100 ndriçuesve me panele diellore, e keni futur në projektin e 2025 e në vazhdim. Ky projekt mesa mbaj mend e kemi votuar dhe për 2024 dhe në dëgjesën publike z.Maksi u premtoi atyre banorëve të fshatit Suk 1 që do ketë 5 ndriçues para Vitit të Ri, kjo është e padiskutuar që do bëhet. Ndërkohë në fshatin Suk 1 na janë mbytur serat, konkretisht unë jam shumë e indinjuar se dhe unë kam një fermë, kam një pronë private 6 dynym serë që sot po noton në ujë. 6 milion e 300 mijë të vjetra i kam vetëm farishte, lëre ç'a dëmi më shkaktohet mua, po lagjes së Kodhelajve atje, kanalet notojnë. I jam lutur z.Maksi sinqerisht i jam lutur, i kam thënë të lutem sille atë skrepin se do e paguaj unë, sepse unë e kam bërë vet pjesën e kanalit, gjithë kanal in atje. Z.Maksi më premtoi dhe smë hapi as telefonin ditën tjetër, kjo është padrejtësi, jo se smë hapi telefonin mua se kush jam unë, por kujtdo qytetari do ti përgjigjet me dinjitet dhe me respekt. Kryetarja M.Bufi-e nderuar këshilltare duhet ta dish që kanalet e treta janë përgjegjësi e fermerit. Dhurata-nuk është kanal i tretë ai po verifikoje njëherë, ta tregoj unë se cili është. Kryetarja M.Bufi-të lutem unë të dëgjova. Dhurata-po ti pse e përsërit kanali i tretë, unë e di që nuk është kanal i tretë, e di shumë mirë. Kryetarja M.Bufi-kanalet e treta janë përgjegjësi e fermerit, kemi kaq kohë që përpiqemi të komunikojmë me fermerët, që kanalet e treta janë përgjegjësi e tyre nuk është e bashkisë, dhe në qoftë se në mes të bllokut gjysma e kanalit nga një individ është i bërë dhe tjetri jo, nuk është përgjegjësi e jona, por unë po ju them që ne jemi përpjekur dhe me punë të vazhdueshme që mjetet e bashkisë ata dy ekskavator që kemi dhe çfarë kemi marr nga bordi herë pas here që i marrim për kanalet që nuk janë përgjegjësi e jona, kanë qënë dhe janë gjithmonë në punë. Dhurata- ku ato 500 m që filmi ju për fasada, atje janë në punë ata? Kryetarja M.Bufi-ky është përceptimi juaj. Dhurata-po jo sepse ka fakte, se unë e shikojë. Kryetarja M.Bufi-ky është përceptimi juaj dhe është e drejta juaj. Kryetari- ju lutem mos të replikojmë. Dhurata- o Kryetar jemi mbytur, e kupton ç'a dëmi ekonomik më shkakton mua dhe fermerëve të tjerë, eja sot hipi makinës dhe shikoje, filloje nga Kodhelajt deri tek Luto Sakaj, të gjitha serat janë nën ujë, gjynah për fermerët. Kryetarja M.Bufi-atë ditë që ka pasur ngarkesë reshjesh, ne jo vetëm me mjetet e bordit por edhe me mjetet e tjera që janë të Ndërmarrjes së Shërbimeve, ne kemi qënë në terren për ti dhënë mbështetje fermerëve aq sa kemi mundur. Në lidhje me ndriçuesat, përmende një investim që është parashikuar blerja e 100 ndriçuesave për vitin 2025, po është e vërtetë i kemi parashikuar. Ju kemi premtuar në dëgjesë publike që ndriçuesat 50 copë të planifikuar për vitin 2024 do të vendosen para Vitit të Ri. Operatori që doli për zot blerjes së këtyre mallrave, i ka sjellë me vonesë ndriçuesat dhe është penalizuar për vonesën nga Bashkia Roskovec, është penalizuar për sjelljen me vonesë dhe mos realizimit në kohë të kontratës, por më në fund ndriçuesat kanë ardhur 50 copë dhe do fillojmë menjëherë Ndërmarrja e Shërbimeve pas Vitit të Ri, se tani nuk ka më kohë dhe moti nuk na premtton, do ta shpërndajmë sipas planifikimit që është bërë, kërkesat e ardhura nga administratorët dhe Kryetarët e fshatrave për ti vendosur ato 50 ndriçues, të cilët do të pasohen vitin që vjen me 100 të tjerë të planifikuar në buxhetin që sot ne kërkojmë të miratohet prej jush. Në lidhje me kamerat, ato kamera që ju shikoni aty në buxhet janë blerje kamerash për çerdhen,

janë blerë kamerat është bërë investimi dhe kamerat janë vendosur, dhe ne vit pas viti do përpiqemi që në të gjithë institucionet arsimore që nuk kanë kamera, ose në sheshet dhe rrugët publike që ne kemi detyrimin për ti vendosur, do përpiqemi rast pas rasti nga pak që ti blejmë dhe ti vendosim kamerat, për të garantuar sigurinë e familjeve tona dhe gjithë qytetarëve kudo që ata ndodhen. Në lidhje me zërin që përmende kosto për rikonstruksionin e ambulancës në Suk 1, po ta shikosh më mirë, ta lexosh qartësisht buxhetin ajo është pjesa jonë e financimit që është minimaliste 10% të vlerës së investimit që ka realizuar projekti “Shëndet për të gjithë” i financuar nga zvicerianët për rikonstruksionin e ambulancës në Suk 1. Ky ishte një partneritet ku bashkia vinte 10% dhe 90% e vinte projekti zvicerian, është realizuar investimi. Dhurata-ku, brenda? Kryetarja M.Bufi-është realizuar investimi si brenda si jashtë, në Suk 1 flasim tek materniteti. Dhurata-po Suku 1 është edhe këtu. Kryetarja M.Bufi-në Suk 1 tek materniteti, ai është investimi që është shënuar në buxhet, në dokumentin që ju kemi paraqitur për miratim. Në lidhje me kontinierët ju kemi paraqitur blerjen e dy lloj kontinierësh, numrin e saktë e keni aty, ne do përpiqemi dhe duam ta realizojmë që këtë radhë, këtë vit që vjen në Roskovec të bëhet një praktikë ndryshe, që në fakt është aplikuar në disa qytete të Shqipërisë por edhe në qytete jashtë vendit. Për shtëpitë private do ta fillojmë në Roskovec pastaj duam ta shtrijmë në gjithë bashkinë në çdo fshat, në shtëpitë private ne duam të vendosim jo kontinier të mëdhenj publik ku hedhin të gjithë mbetjet, por duam të vendosim kontinier maksimumi 20-25 kg, në mënyrë që ne kontinierin tja japim çdo shtëpie dhe shtëpia ta mbaj brenda oborrit të vet për mbetjet e veta, që aty mos të sjellin të tjerë dhe duke e mbajtur kontinierin brenda shtëpisë së vet është më i sigurt, ruhet nuk prishet, nuk dëmtohet nga të tjerët. Ne do ti lëmë orar sipas një grafiku të caktuar, që kjo lagje kontinierët duhet të dalin në këtë ditë dhe këtë orë, e nxjerr nga shtëpia shkon makina dhe punëtorët e pastrimit e heqin, dhe përsëri i zoti i shtëpisë e mban këtë kosh brenda territorit të vet, sepse në këtë mënyrë siç e kemi që vendoset një kontinier publik që nuk dihet kush e dëmton, në shumë raste na dëmtohen ose i marrin i hedhin në kanal, ose i djegin kur janë plastik, se ka dhe raste kur janë plastik. Kemi mbetje të cilat nuk duhen hedhur aty në kosh, përshembull mbetjet bimore nuk duhen hedhur në këtë kontinier, mbetjet inerte nuk duhen hedhur në këtë kontinier sepse kanë ditë të tjera që hiqen nga ndërmarrja. Pra kjo lloj praktike që është e njohur në disa qytete, ne duam ta zbatojmë për Roskovecin dhe në qoftë se do të jetë eficient, do të jetë më efektiv në pastrimin dhe grumbullimin e mbetjeve, atëherë do përpiqemi që këtë lloj mënyre ta bëjmë në gjithë territorin e Bashkisë Roskovec. Prandaj ju shikoni atë zërin atje, blerje kontinierësh dy llojesh që njëra ka të bëjë me këtë gjë, ndërsa tjetra ka të bëjë me blerjen e një sasive më të vogël kontinierësh të mëdhenj, të cilët në fakt ka zona në territor që nuk e plotësojnë nevojën dhe sasinë e duhur për kontinier, ne jemi detyruar që ti vendosim, ose ka kontinier të cilët janë dëmtuar, atëherë do ti zëvendësojmë. Për pastrimin që thatë ju znj.këshilltare që nuk bëhet pastrimi, unë e pranoj se njerëz jemi nuk jemi perfekt, e pranoj që mund të ndodh që diku pastrimi edhe mund të vonojë, edhe mbase nuk bëhet në orarin e caktuar dhe sipas grafikut të caktuar, por që të ketë zona që rrinë 6 muaj jo e jo njëherë nuk ka shanse, as 3 muaj. Dhurata-4 muaj se unë atje kaloj. Kryetarja M.Bufi-nuk ka shans që të rrijë një kontinier i tej mbushur, mund të ndodh një ditë..Dhurata-me fal ta hedh vidion ta shohesh? Kryetarja M.Bufi-të lutem, kaloje vidion që ta shoh patjetër, po kjo nuk ndodh nuk ka shanse. Unë them që ne e pastrojmë mirë territorin, mund të kemi edhe gabime nuk e vë në dyshim këtë gjë që mund të ketë dhe gabime, punëtorët të lodhur, ndoshta më shumë kërkesë llogarie duhet të bëjmë ndaj ndërmarrjes dhe drejtorit përkatës, patjetër që po por në përgjithësi kemi një pastrim që themi që është i mirë. Në lidhje me rrugët me çakull, ka një kontratë që ishte parashikuar brenda vitit 2024,

nuk është ezauruar e gjithë, pra mbushja e rrugëve të parcelave me çakull nuk është ezauruar e gjithë, ka një afat 6 muaj jemi brenda afatit, do të fillojmë menjëherë mbushjen me çakull padysim të gjithë rrugëve të parcelave. Ky është një shërbim që ne nuk mund të pretendojmë që e bëmë këtë vit dhe sdo ta bëjmë vitin tjetër. Dhurata-më fal po ishte për 2024, ku shkoi fondi? Kryetarja M.Bufi-pra nuk është ezauruar po them, shtyhet për vitin tjetër. Dhurata-po mbaroi viti Janar 2024-Dhjetor 2024, çka do të thotë kjo? Kryetarja M.Bufi-zonjë edhe njëherë, nuk është ezauruar fondi. Dhurata-po ikën ditët, ikën muajt. Kryetarja M.Bufi-o zonjë ka element financiar që e transferon fondin për vitin që vjen. Dhurata-po jo Kryetare se kjo është e padrejtë. Kryetarja M.Bufi-ky është mendimi juaj. Dhurata-jo, është mendimi i komunitetit jo vetëm i imi. Kryetarja M.Bufi-ky është një shërbim që normalisht ne nuk mund ta themi dot që e dhamë në 2023 dhe sdo ta japim në 2024 ose sdo ta japim në 2025. Dhurata-kështu do ta shtyni dhe për 2025. Kryetarja M.Bufi-pra rrugët në qoftë se ti e mbush me çakull tani, çakull është gjatë përdorimit, kalimit të mjeteve, kushteve atmosferike patjetër që gropa krijohet përsëri. Dhurata-po ashtu kemi dhe asfaltin që është shembur ngjysëm për ngjysëm. Kryetarja M.Bufi-ne jemi munduar që ti shërbejmë qytetarëve dhe fermerëve kudo që ata janë. Në lidhje me investimin tjetër që përmende rruga para shkollës, është një investim i planifikuar, është realizuar. Dhurata-sa e ka gjerësinë ajo rrugë, ke vajtur ndonjëherë, se ke shkuar ti atje. Kryetarja M.Bufi-do ta verifikojmë, ka supervisor për këtë punë që mban përgjegjësi, do bëjmë matjet e investimit, të parametrave të rrugës. Dhurata-ajo bankina e kanalit u bë atje, se ishte në projekt ajo? Kryetarja M.Bufi-dhe mbikqyrësi përgjigjet për përgjegjësinë që ka marr për çdo investim që kontrollon, të jeni të bindur ju zonja këshilltare dhe kushdo tjetër që paraqet një dyshim, që ka një hije dyshimi, është i lutur është i hapur të kërkoj informacione siç po ua them tani këtu, dhe me shkrim nëse dëshironi, por po ju them supervisorin dhe mbikqyrësin i punimeve që janë përgjegjësa ligjor dhe teknik, kanë përgjegjësi për verifikimin dhe kontrollin e çdo investimi në territor. Dhurata-më fal po kështu për rrugët, kështu për kanalet që i bërë nga shtëpia e Qamil Cjapit deri tek argjinatura, kështu rruga nga Hyrinjt që kalon tek shkolla, kështu rruga tjetër te ne që bërë tek shkolla, kështu depoja e ujit, kështu do ti kaloni të gjitha situatat ju, jo supervisorin jo ky jo ai, pse ja hidhni topin njëri-tjetrit, smbani përgjegjësi fare, se ti nuk vjen as në dëgjesa publike asnjëherë kur të kërkon populli, ti shkon atje ku të intereson, merr dy persona nga pas shkon tek serat. Eja tek sera ime të pres unë znj.Kryetare, eja sot bëj një vizitë, kam dhe unë kënaqësi se banore e kësaj zone jam e këtij qyteti. Eja pra në serën time sot konkretisht, shikoje 6 dynym nën ujë atje, eja pra pse nuk vjen? Kryetarja M.Bufi-pastroje kanal in mos e lër pa pastruar. Dhurata- e kam pastruar kanal in, por efienca juaj si bashki, si bëni punët që ju takojnë. Kryetarja M.Bufi-pastroje kanal in ti edhe çdo fermer tjetër që e lë kanal in pa pastruar, fermerët kanë detyrim që kanalet e treta ti pastrojnë. Dhurata-të lutem shumë je ti menaxhuesja e institucionit, ti kërkoja, ti zbatoj. Kryetarja M.Bufi-të lutem, përgjigjen ta dhashë. Kryetari-znj.Kryetare le të ngelemi tek përgjigja, znj.Dhurata dëshironi akoma kohë për të mbaruar diskutimin tuaj? Dhurata-nuk kërkoj, faleminderit. Fredi-e para, për mbrojtjen nga zjarri keni parashikuar për vitin 2024 13 milion e 859 mijë, për vitin 2025 22 milion e 398 mijë, çka është parashikuar? Në këtë moment këshilltarja Dh.Malka largohet nga mbledhja. Prezent tani në sallë 18 këshilltar. Fredi-për problemin e ujit të pijshëm në fshatin Ngjeqar, pasi unë kam bërë edhe kërkesë dhe ju nuk ma miratuat kërkesën për një investitor human për të bërë disa çezma. Vet ju znj.Kryetare bëtë një çezëm, ta hodha vidion tani, këshilltarët e tjerë e kanë ua kam shpërndarë vidion, ajo nuk është funksionale, ajo është tallje. Çka keni parashikuar për vitin 2025 se janë 240 familje të paktën që banojnë, se taksapagues janë 330. Për të gjithë drejtorët e shkollave, mesa di unë mesa kam

informacion, bëjnë një listë kërkesë drejtuar bashkisë për të gjitha materialet që kërkohen. A i keni parashikuar dhe plotësuar nevojat për vitin 2025? Për kazanët e mbetjeve/plehrave, çfarë është parashikuar për vitin 2025, se në bazë të një verifikimi që kam kryer në 2024, në kazan të ndryshëm në fshatra të ndryshëm, dizifektimi nuk ekziston që të jetë bërë me klor, çka keni parashikuar? Unë nuk jam specialist pavarësisht se kam bërë një analizë timen, çfarë keni parashikuar ti spërkatni, ti dizifektoni koshat e plehrave, me gëlqere? Pasi kanë një diferencë shumë në çmim. Rrugët e fshatrave, të paktën rruga kryesore të fshatit Vlosh-Ngjeqar është katastrofë. Rrugët e tokave janë shumë keq. Ne marrim bashkinë Mallakastër, një fshat Rripan quhet model, të gjitha rrugët e tokave janë të bëra nga bashkia, ju çfarë keni menduar? Ju vërtet bëni festën e ullirit por nuk ka rrugë të venë të vjelin ullinjtë banorët. Kryetarja M.Bufi-në lidhje me fondin që ju përmendët për zjarrfikësen, fondi është totalisht nga qeveria, nuk ka asnjë lekë nga të ardhurat e bashkisë. Selmani-këtu është futur edhe emergjenca civile që ne kemi marr. Kryetarja M.Bufi-pra është një masë financiare e cila vjen qoftë për emergjenca civile, qoftë për zjarrfikësen, vjen totalisht nga qeveria, vjen dhe ne kemi detyrimin që qoftë për punonjësit, për veshjet e tyre, janë të dedikuara për zjarrfiksen ne nuk lëvizim dot. Pra ai fond vjen i destinuar dhe do përdoret për qëllimin që vjen. Në lidhje me emergjencat civile, kërkesat janë si kjo e zjarrit ose çfarë mund të ndodhi gjatë vitit, dëme, shkarje, problematika të cilat futen tek emergjencat civile, ne kemi detyrimin që ti ezaurojmë, janë fonde që vijnë nga qeveria. Përmendet problemin e rrugës kryesore të Ngjeqarit, besoj e keni marr vesh sepse është bërë publike, ku ne Bashkia Roskovec ka lidhur marrëveshje me FSHZH, është firmosur marrëveshja që besoj përderisa është firmosur marrëveshja quhet një fakt tashmë, jo që është më me pikëpyetje, por besoj që do realizohet dhe investimi për asfaltimin e rrugës nga ura e Vloshit deri në lagjen Stan, do kryhet nga FSHZH me financim të këtij fondi. Fredi-është tenderuar? Kryetarja M.Bufi-e bën tenderin FSHZH. Fredi-ju skeni projekt znj.Kryetare. Kryetarja M.Bufi-zotri edhe njëherë po ta shpjegoj, projekti,tenderimi,zbatimi i kryen FSHZH dhe kur lidhet marrëveshja për zbatim do të thotë që të gjitha këto janë ezauroar, i ka kryer FSHZH jo bashkia. Bashkia është institucioni përfitues ku kryhet ky investim dhe vetëm firmos marrëveshjen që nxjerr lejen e ndërtimit. Unë besoj se shumë shpejt, nuk mund të them sot, nesër se nuk jemi ne institucioni që bëjmë zbatimin e investimit, është FSHZH, por marrëveshja e lidhur tregon që kanë kaluar të gjitha këto hapa dhe shumë shpejt do filloj puna për përmirësimin dhe asfaltimin e rrugës kryesore të Ngjeqarit. Në lidhje me ujin e pijshëm, uji i pijshëm në Ngjeqar është një problem që jo vetëm thjesht për përgjegjësinë ligjore që nuk e ka bashkia, sepse ju e dini që ka gati 3 vjet që përgjegjësia e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të zeza i ka kaluar Ministrisë, nuk i ka më bashkia por jo vetëm prej kësaj por edhe moralisht me informacionet që ne kemi, me përpjekjet që ne kemi bërë si bashki, është një problem që nuk e zgjidh dot bashkia. Ne e kemi referuar kërkesën tonë, jo vetëm thjesht si një shkresë zyrtare se nuk mjafton vetëm kjo,por si një problem shumë emergjent që fshati Ngjeqar ka, për të zgjidhur problemin e ujit të pijshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjelles-Kanalizime dhe Ministria përkatëse. Besoj që me vëmendjen që ka marr ky problem, gjatë vitit që vjen do ti jepet zgjidhje, se çfarë zgjidhje konkrete nuk di ta them, por besoj do ti jepet zgjidhja. Në lidhje me çezmën ne e diskutuam këtë gjë edhe me Kryetarin e fshatit, edhe me këshilltarin tjetër z.Nazmi edhe në mbledhje të grupit. Bashkia kishte planifikuar vitin e kaluar ndërtimin e tre çezmave, një në Ngjeqar, një në Luar dhe një në Mbërs, nga këto janë realizuar vetëm dy, nuk është bërë Luari, është bërë Mbërsi që është funksional dhe Ngjeqari nuk është funksional, është pra një punë e cila nuk është bërë mirë, operatori nuk është paguar për këtë gjë, për asnjë nga këto. Përveç detyrimit që ne si bashki kemi edhe ta penalizojmë

ligjërisht operatorinn por edhe ta detyrojmë të bëj punën siç duhet në parametrat e duhur, që ti jap zgjidhje kësaj çështje, ne kemi rënë dakort në mbledhje grupi që të shtojmë fond sot, Selman duhet ta gjesh këtë gjë, sipas preventivit që drejtorja e Planifikimit të Territorit më solli, për të shtuar edhe ndërtimin e një çezme tjetër në Ngjeqar në lagjen Kurtaj. Pra një që është bërë jo mirë do bëhet ashtu siç duhet dhe një tjetër të re, të shtojmë fondin për të patur të paktën dy çezma në fshatin Ngjeqar, derisa qeveria shqiptare dhe Ministria përkatëse ti japi zgjidhje problemit të furnizimit me ujë të fshatit Ngjeqar, del përtej kompetencave dhe mundësive të bashkisë, por kjo nuk do të thotë që nuk është përgjegjësia jonë morale. Ngrite problemin e rrugëve të arave, rrugët e arave kanë qënë dhe do të mbeten prioriteti ynë. Kemi problem se nuk kemi mjetet e duhura, për të marr një buldozer i cili do bëj të mundur hapjen e rrugëve në mënyrën më të mirë të mundshme, sidomos në rrugët kodrinore se rrugët e zonave fushore janë më të lehta për tu mirëmbajtur dhe për tu sjellë në formën e duhur, për tu aksesuar nga fermerët. Një kërkesë që kemi bërë dhe shpresojmë të merret në konsideratë tek Agjensia e Emergjencave Civile në Tiranë, që përveç projektit që ne aplikojmë çdo vit, të kemi dhe një mjet buldozer, i cili do të shërbejë kryesisht dhe në radhë të parë për hapjen e rrugëve të parcelave bujqësore, sidomos në zonat kodrinore. Në lidhje me kontinierët e plehrave, në dijenin time por nuk ta kundërshtojë fjalën, është hera e parë që nuk ta kundërshtojë, në dijenin time unë di që ne pastrojmë, por nëse ka probleme të tilla si ajo që më thua, që nuk pastrohen dhe nuk klorifikohen..Fredri-klorifikohen por nuk është klor. Kryetarja M.Bufi-klorifikohen thashë, këtu unë qëndroj të jap të drejtë, duhet të kemi pak më shumë vëmendje dhe kontroll për të përmirësuar këtë gjë. Është e vetmja gjë për të cilën unë të jap të drejtë, të tjerat ke ngritur shqetësime por nuk është se nuk janë të njohura nga ne, nuk është se nuk përpiqemi për ti dhënë zgjidhje, bile mund të them me krenari, mund ta them këtu para jush që fshati Ngjeqar është një nga fshatrat që të paktën në dy vitet e fundit ka përfituar investime më shumë se çdo fshat. Kryetari-faleminderit znj.Kryetare, dikush tjetër e kërkon fjalën për pyetje? Kryetarja M.Bufi-më fal, kishe dhe një pyetje tjetër në lidhje me shkollat që ngriti këshilltari, kishte të bënte me materjalet e shkollave. Në dijenin time dhe që besoj e di mirë këtë gjë sepse është diskutuar kjo gjë, bile drejtorat e shkollave kanë marr dhe përgjigje, në lidhje me kërkesat higjieno-sanitare ne u plotësojmë kërkesat çdo shkolle, në qoftë se ka nevojë për rritje do ta shikojmë dhe mund ta rrisim këtë gjë, por ne nuk u plotësojmë kërkesat shkollave për çështje kancelarike, për çështje printimi, këto janë kërkesa dhe detyrime që shkollat duhet ti zgjidhin vet me Ministrinë, me Drejtorinë Arsimore. Vetëm për çështjen higjieno-sanitare ka detyrim dhe mirëmbajtjen e godinave ka detyrim bashkia. Kryetari- të nderuar këshilltar, ndërkohë që unë formuloj pyetjen time, ju lutem që ti referoheni projekt-vendimit të cilin ua kemi shpërndarë në datën 18. Projekt-vendimin të cilin ne ju kemi shpërndarë shprehet : ju paraqesim për diskutim e miratim : pika 1- të miratojë dokumentin përfundimtar për programin buxhetor afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Roskovec dhe 4 njësitë shpenzuese në varësi, sipas tabelave bashkëlidhur siç dhe janë ngarkuar në SMFV. Po ashtu pika 2 e këtij projekt-vendimi është përsëritje e pikës së parë, shoh që është përsëritur e njëjta pikë. Pika 3 është të shpërblejë anëtarët e Këshillit Bashkiak dhe Kryetarët e fshatrave në masën 10% të pagës së Kryetares së Bashkisë, dhe 4 ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi. Pyetja ime është kjo, qëndron ky projekt-vendim apo kemi ndryshime? Selmani- tek pika 2 është siç e ka dhe vet titulli tek projekt-vendimi, për miratimin e dokumentit përfundimtar dhe buxhetit të vitit 2025, normale që pika 2 do të jetë vetëm për buxhetin e vitit 2025 me gjithë A dhe B. Kryetari-ju lutem drejtor ti referoheni edhe njëherë projekt-vendimit, shprehu qartë për formën përfundimtare, të cilën duhet unë ta hedh në votim, ju lutem që ti lexoni edhe njëherë pikat.

Selmani- pra pika e parë qëndron ashtu siç është, pika e dytë në vend të PBA 2025-2027 duhet për vitin 2025. Kryetari- të lutem ta perifrazosh në mënyrë që ta mbajmë shënim në protokoll. Selmani-po, pika tre qëndron ashtu siç është dhe ka të bëjë me shpërblimin e anëtareve të Këshillit dhe Kryetareve të fshatrave. Duhet një pikë katër të cilën ne e kemi ndryshuar aty, për numrin maksimal të punonjësve, sepse ndryshe nga viti i kaluar nuk mund të shpreheshim në emërtim lart, por duhej me një pikë të veçantë për numrin maksimal të ndarë në institucione, njësia shpenzuese Bashkia Roskovec ka 184 punonjës, njësia shpenzuese Ndërmarrja e Shërbimeve Publike 207 punonjës të përhershëm dhe Gjëndja Civile 4 punonjës të përhershëm. Gjithësej 395 punonjës të përhershëm. Kryetari-faleminderit, atëherë për diskutime kush e kërkon fjalën? Fredi-znj.Kryetare ne këtu kemi miratuar një buxhet në 2024, që e kemi zbatuar ju për 2024, është parashikuar dhe sipas përgjigjes që ju më dhatë, është parashikuar në buxhet për kancelari por nuk më rezulton. Kryetarja M.Bufi-nuk është parashikuar. Fredi-në fillim të buxhetit. Kryetarja M.Bufi-po jo për shkollat, është për bashkinë jo për shkollat. Fredi-për kancelari, për pastrim, për detergjent, më lër të mbarojë, dhe më rezulton se dy shkolla kanë një fshesë znj.Kryetare, u është dhënë nga bashkia një fshesë. Kryetarja M.Bufi-po ti sje atje, nuk verifikon këtë gjë. Fredi- këtë mund ta verifikoj unë, mos më bëj lojra fjalësh të lutem. Është parashikuar në buxhet për kancelari në Bashkinë Roskovec por më rezulton ndryshe znj.Kryetare, që në 27 Gusht nuk ka patur bojë shkrimi për printerat. Kryetarja M.Bufi-nuk është detyrë e bashkisë edhe njëherë po ta them, ti mund të flasësh çka të duash po.. Fredi-ka mundësi të më lejosh, ti mbase e ke mënyrë për të më acaruar mua, por unë nuk ndërpres njeri. Kryetarja M.Bufi-unë nuk po të acarojë fare. Fredi-ka mundësi të më lejosh të mbarojë? Është parashikuar buxhet për shpenzime për dizifektimin e kazanëve për klor, dhe na rezulton gëlqere. Është parashikuar buxhet por një makinë e mbeturinave të bashkisë digjet motorri vetëm për atblu, është një material një lëng që hidhet për përzierje të motorrit bashkë me naftën sepse kështu e kërkon materiali. Makina është marka Nisan, vetëm se është kursyer dhe është djegur nuk punon makina, punon por me të shtyrë. Unë erdha në zyrë tek ju pas fjalës që më thatë këtu që bëni kërkesë për një investitor human, ai jetonte jashtë shtetit, për një çezëm për në Ngjeqar, ju më thatë bëni një kërkesë dhe do ta miratojmë. Erdha në zyrë bëra kërkesën dhe ju nuk e miratuar znj.Kryetare. Nga njoftimi që më bëri sekretarja juaj më tha kalo njëherë nga znj.Kryetare, e kupton? Kjo më duket absurde dhe nuk kalova se skisha pse të kaloja. Unë bëra zyrtarisht në bazë të fjalës tuaj, erdha e bëra, me fotokopje me të gjitha dhe më thatë të vij investitori vet nga Amerika, i binte të paguante nja 3 mijë dollar ai se 2 mijë dha për çezmën ai, por ty të tingëllonte keq sepse ai investitori më tha që ta bëj Fredi, unë shyqyr zotit e kam një pus, e kam 120 kuita ujtë për 24 orë, por gjynah për fshatin. Bëni kaq buxhet këtu për parashikime, për ngrohjen globale e fasada, nuk bëni një çezëm por talleni, dërgoni dhe polic në fshatin Ngjeqar te çezma se kujtonit se po e bënte Fredi pa leje atë çezmën atje. Dërgove polic bashkiak por nuk rezultoi ashtu, as investitori nuk ju pyeste ju, kishte ardhur pa lejen tuaj, ka ardhur ka hedhur beton atje, është tallje. Mbase ju e kemi për inat sepse nuk kishit rezultatet që ju prisnit për zgjedhjet për veten tuaj dhe hakmerreni me atë fshat, por është gjynah. Më rezulton ndryshe se ne miratojmë buxhet këtu, por ato tabelat e rrugëve nuk e kuptoj me çka morali, me çka ligji u kërkohet banorëve pse të kam vendosur emrin e gjyshit do paguash tabelën e rrugës. Nuk e di është ligjore se morale jo e jo, se turp se unë i kam bërë naftën asaj table, se gjyshi ose stërgjyshi në qoftë se kanë lënë emër, kanë nevojë për të shkruar unë, por kjo është antiligjore dhe pa moral. Nëse duhet një fond ta miratojmë këtu dhe tu kthejmë lekët atyre banorëve atje se është turp i zotit. Dridhet banori heq koren e bukës aty, 80 mijë lekë thotë duhet paguar për tabelat e rrugëve. Këtu kanë ardhur në

buxhet, kemi miratuar edhe sot edhe çdo herë, le që i keni futur në sherr pse kane çuar gjyshin tim, pse skanë çuar, unë kam votuar ai ska votuar, e kupton është tallje. Ju keni ngritur një sistem këtu në qoftë se ske votuar për mua të heqim nga ndihma ekonomike, në qoftë se ske votuar për mua nuk të miratojmë fondin e emergjencës atij që i janë djegur shtëpitë, në qoftë se smë ke votuar mua unë hakmerrem, unë stë miratoj çezmën atje në fshat. Nuk e kuptoj feudal, neofeudal sepse unë nuk e di ç'a emri ti vë, edhe nuk të dija kaq ambicioze që të merresh me fshatin. Në qoftë se stë ka votuar Fredi ske pse hakmerresh, atje të kanë votuar shumë njerëz. Kryetarja M.Bufi-z.këshilltar, fole dhe ke të drejtën tënde, juve dhe gjithë të tjerët që të shpreheni sigurisht jeni përpara qytetarëve, ka jo vetëm një arsye pse duhet të shpreheni siç doni ju dhe siç e gjykoni ju. Këtu jemi në Këshillin e Bashkisë dhe marrim vendime për qytetarët dhe të gjitha vendimet janë të shkruara, shkruhen, mund të jetë bërë dhe ndonjë lapsus i cili verifikohet, kontrollohet, monitorohet, mbahet përgjegjësi dhe për çdo fjalë që thatë minimalisht duhet të mbani përgjegjësi morale. Fredi-unë mbaj morale dhe ligjore, në qoftë se nuk rezultojnë të gjitha këto me dëshmitar, unë mbaj përgjegjësi për këto që thashë, i kam me fakte, të shkruara me fakte dhe në qoftë se, unë bëj dorëheqje si këshilltar ose bëj kallëzim penal. Kryetarja M.Bufi-të lutem shumë unë nuk të ndërpreva fare. Çdo vendim që merret këtu zbatohet ashtu siç shkruhet. Në qoftë se do të jesh një kontributor nga komuniteti, ka një procedurë ligjore i nderuar, dhe nuk mund të bëhet me dëshirë prit se erdhi dikush nga Amerika, dikush nga fshati. Dera është e hapur. Fredi-po lëre fshatin ti, lëre pa ujë fshatin ti. Kryetarja M.Bufi-të lutem shumë se unë nuk të ndërpreva, por edhe një herë po të them, kushdo që do të bëj një kontribut të vij të bëj kërkesën në sistem siç e parashikon ligji, bëhet projekti, ndahet vlera dhe masa e kontributit për atë që do kontribojë dhe si do kontribojë dhe brenda afatit që do kontribojë, dhe ky investim sado i vogël qoftë bëhet publik. Në qoftë se do bujrum bëj kërkesën në sistem kur të duash, bëjmë projektin dhe e bëjmë këtë gjë, por jo me dëshirë, jo me fjalë dhe jo me kështu vullnetarizma si ato që duam ti bëjmë për shou apo siç mund ti dojë dikush tjetër. Fredi-e kam adresuar kërkesën me shkrim. Kryetarja M.Bufi-dakort, në qoftë se e ke bërë me shkrim në sistem do ta shohim. Fredi-lëre ç'a sistemi, ato që thoni ju janë lojë fjalësh, znj.Kryetare më ngjite lart në zyrë, në qoftë se nuk qëndron kështu siç them unë.. Kryetarja M.Bufi-jo, tek zyra ime jo, tek sistemi. Fredi-sekretarja juaj më tha kalo nga Kryetarja. Kryetarja M.Bufi-nuk ke fare të drejtë dhe fare asnjë shans që të vish tek unë, ka një sistem. Fredi-kam gjithë të drejtën absolutisht, ta kam bërë ashtu siç e kërkoje në mbledhjen e Këshillit dhe për këtë mbaj përgjegjësi. Kryetarja M.Bufi-siç e kërkon ligji jo unë. Fredi- lëre ligjin mos më trego ligjin, unë i kam bërë si doni ju. Kryetarja M.Bufi-siç e kërkon ligji, shko atje në sistem bëj kërkesën me shkrim dhe do jesh i gatshëm dhe i mirëseardhur për të bërë çfarëdo lloj investimi që duhet, dhe do them faleminderit publikisht. Për çdo investim të kryer jo mirë cilësisht dhe në afatin e duhur, çdo operator mban përgjegjësi, edhe ai i çezmave që po thua ti që ka bërë gjithë atë mur, paratë e tij harxhoi se ska për të marr asnjë kokërr leku, dhe atë po ta them unë me përgjegjësinë e Kryetares së Bashkisë, kokërr leku ska për të marr dhe pse e bëri ashtu. Ai do bëj punën që duhet të bëj sipas ofertes që është përgjigjur në tender, në kontratën që ka lidhur, në të kundërt do penalizohet. Dhe gjithçka tjetër që ju thoni qoftë për ujësjellësin, qoftë me rrugët, o ka marr investime Ngjeqari dhe o do marri, kjo ska asnjë lidhje fare me ato që thatë ju në lidhje me votën dhe gjithçka tjetër. Votën e jep ai që dëshiron, unë nuk ja shikoj votën njeriu, sja shikoj dot asnjëri votën, po ka respekt për punën që është bërë voton,po ska voton tjetrin alternativën që do, po këtu nuk mund të bësh dot demagogji dhe politikë. Nëse ka problematika që unë vet ta shpreha, nëse ka probleme në lidhje me pastrimin apo me çdo lloj shërbimi tjetër që nuk ka vajtur mirë ndoshta në një moment të caktuar,

patjetër që po, duhet të shtojmë vëmendjen, kërkesën e llogarisë, bashkëpunimin për ta përmirësuar këtë gjë, sepse nuk jemi më perfektët është një gjë që duhet pranuar, por kjo nuk mund të hedhi poshtë, të fshijë të tërë atë punë të përditëshme që bëjmë ne në çdo lloj drejtimi, në çdo cep të Roskovecit, dhe pa dalluar asnjë qytetar i majtë apo i djathtë qoftë. Nuk ka më diskutime. Kryetari-ju ftoj të nderuar këshilltar të votojmë projekt-vendimin “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetin e vitit 2025” me ndryshimet : pika 2 ndryshon në : të miratoje buxhetin e vitit 2025 për Bashkinë Roskovec dhe 4 njësitë shpenzuese në varësi sipas tabelave bashkëlidhur siç dhe janë ngarkuar në SMFV. Shtohet pika 4 : të miratojë numrin maksimal të punonjësve të bashkisë si dhe të njërive administrative e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë për vitin 2025, gjithësej 395 punonjës të përhershëm, nga të cilët : Njësia shpenzuese Bashkia Roskovec 184 punonjës të përhershëm, njësia shpenzuese Ndërmarrja e Shërbimeve Publike 207 punonjës të përhershëm, Gjëndja Civile 4 punonjës të përhershëm. Pika 5 ngarkohet ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi. Kryetarja kishte merak të shtohet, Kryetare? Kryetarja M.Bufi-unë do doja të thoja që sipas diskutimit që bëmë, propozimit që bëri Nazmiu drejtpërsëdrejti në mbledhje grupi, por edhe diskutimit që bëri këshilltari Feleqi, të shtohet në investime shtimi i një çezme në lagjen Kurtaj në Ngjeqar. Kryetari-kjo do të bëj që të na ndryshojnë tabelat, apo jo? Kryetarja M.Bufi-e bën rregullimin Selmani. Selmani-do bëhet dhe në sistem, do ndryshojnë tabelat por një ndryshim i vogël. Kryetari- sigurisht, vetëm tabela të cilës i referohet investimi i diskutuar në këtë mbledhje. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2025-2027 dhe buxhetit të vitit 2025” me ndryshimet e përmendura më sipër, ndryshimi i pikës 2 dhe 4 si dhe shtimi i një çezme në fshatin Ngjeqar, dhe miratohet me 14 vota pro, 4 vota kundër nga F.Feleqi, E.Xhaxhaj, A.Hoxha, A.Pelo. Miratohet. Kryetari-faleminderit të nderuar këshilltar, dhe përpara se të kalojmë në pikat e tjera të rendit të ditës, fjalën e ka Kryetarja e Bashkisë. Kryetarja M.Bufi-më lejoni të them dy fjalë, faleminderit të gjithëve, për të gjithë ata që votuan pro dhe ata që votuan kundër. Në këtë moment këshilltarët F.Feleqi, E.Xhaxhaj, A.Hoxha, A.Pelo largohen nga mbledhja. Prezent tani në sallë 14 këshilltarë. Kryetarja M.Bufi- dua të falenderoj grupin e këshilltarëve të majtë dhe të falenderoj dhe Pegiolën që besoj me vendimmarrjen e sotme bëhet pjesë e grupit tonë? Pegiola mund të ma shprehësh këtë të lutem? Pegiola-nuk është se kam ndonjë arsye kundra për të mos qënë dakort, janë vendime që duhen marr si me votën e këshilltarëve të djathtë, si me votën e këshilltarëve të majtë. Nëse janë vendime që duhen marr për të mirën e qytetarëve, sigurisht që do votojmë pro.

9.Për miratimin e kalendarit të Menaxhimit Buxhetor për vitin 2025.

Kryetari-jeni njohur me materjalin, ka nevojë dikush për sqarime të mëtejshme në lidhje me këtë projekt-vendim? Fjalën për pyetje, për diskutime e kërkon njeri? Nuk ka. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 14 vota pro.

10.Për miratimin e ndihmës nga fondi i kushtëzuar për djegien e banesës së Barjam Shehu, Bashkia Roskovec për vitin 2024.

Elmazi-në radhë të parë, dhe ata që u larguan dhe ne që jemi këtu brenda jemi përgjigjur në emër të Bashkisë gjithmonë, dhe Këshilli ka qënë një trup i vetëm për të ndihmuar njerëzit që kanë pasur fatkeqësira natyrore. Gjithashtu mendoj ta kalojmë dhe ne ti ndihmojmë qytetarët kudo qofshin, i

këtij mendimi jam ta kalojmë. Ska më pyetje dhe diskutime. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

11.Për miratim fondesh shtesë në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2024.

Kryetari-kjo është një pikë për të cilën në fillim të kësaj mbledhje besoj që moret informacion mjaftueshëm, se për çfarë bëhet fjalë në këtë projekt-vendim. Kërkon dikush që të njihet më hollësisht? Nuk ka pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

12.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Qytetari Flamur Çepele- kisha një vërejtje, ka ndonjë disiplinë ky Këshilli që largohen në mes, parantezë kjo si qytetar. Meqënëse është fundi i vitit thashë dhe unë të bëj një bilanc, po jo bilanc arritjesh pozitive siç i keni ju mazhoranca juaj, sidomos me atë iceneratorin, me atë helmin toksik atje, kam dhe unë nja ca pika që i kam drejtëpërdrejtë me familjen time. Kam një pyetje, përse u bë reforma territoriale? Është bërë për uljen e hallkave të punonjësve nëpër komuna që ishin atëherë, është bërë për shërbimet që të jenë sa më afër qytetarëve. Energjia elektrike më ndërpritet 3 herë në ditë, më është djegur 3 herë frigoriferi, televizorin dua 1 orë ta rregulloj mbrapa. Roskoveci kam dëgjuar që do futet në librin Gines për 1000 ndërprerje të energjisë elektrike në këtë vit. Do thoni ju që skanë lidhje këto, kanë lidhje se ju përgjigjeni për hallet e komunitetit edhe ndërhyini,kurse unë nuk ndërhyjë dot se smë dëgjon njeri. Uji i pijshëm ka patur një përmirësim që vjen pothuajse gjithë ditën por është blozë, na i prishi pajisjet hidraulike shtëpiake. Këtu skemi asnjë lloj shërbimi siç u tha atëherë që do vij drejtoria e ujërave, drejtoria elektrike, Kadastra do vij këtu. Kadastrën unë e kam 1000 vite larg, kam 16 vite që kam aplikuar, e kam 1000 vite larg. Në të njëjtën kohë kur këtu në zyrat e pushtetit thirren ata që preferon pushteti, thirren dhe ua japin hipotekën në dorë, kurse mua që jam i paanshëm, i pavarur nuk më vjen, me këtë jam shumë i pezmatuar. Përse largohen njerëzit dhe të rinjtë? Largohen sepse këtu nuk ka burim punësimi. Kryetarja që vete pothuajse muaj për muaj jashtë, në një qytet si i joni mund të ketë 10 fabrika, sepse për atë punë është që të kërkojë donator që andej që të rregullojë këtu, një qytet si i joni andej ka 10 fabrika kurse ne kemi vetëm 2 furra buke këtu. Kjo është mungesë e pushtetit vendor këtu dhe e qeverisjes vendore. Përse largohen të rinjtë? Largohen se nuk i japim mundësinë për tu marr me sportin, ka shumë të rinjë këtu që janë futbollista shumë të mirë, por nuk u jepet mundësia, se ajo fusha e sportit aty ka ngelur për në fund fare. Në 8 vjet të këtij pushteti janë bërë 8 herë vendime, keni marr dhe ju miratim për ndërtimin e stadium-park atje, dhe akoma e kësaj dite nuk është vënë dorë. Fusha e sportit sot po të vesh atje është e paluajtshme, është mbushur vetëm me ujë.Unë si qytetar jam shumë i shqetësuar për këto. Këto kisha, kisha dhe anën personale që smë jepet Kadastra se për atë kam ardhur më shumë mos ta mohoj, edhe anët e tjera, pse duhet ti kemi shërbimet neve në Patos përshembull që është elektriku ? Kryetari- faleminderit z.Flamur për të gjitha shqetësimet që solle në këtë mbledhje të Këshillit. Këtu kemi dhe punonjës të administratës, besoj se të gjitha këto shqetësime do të adresohen drejtë pranë institucioneve dhe zyrave përkatëse. Kryetari i fshatit Suk 2 Shkëlqim Toska- kam shumë atje në fshat që më kërkojnë numrin e AMTP-së,janë shumë toka pa regjistruar. Ju si këshilltar të bashkisë, ngrihet dhe ikën ai, për çka ikën, këto të ngrrejë ai se këto zgjidhen nga këshilltari, pse se ngrrejë zërin për këtë ata? Kam bërë listën unë, vetëm në fshatin

tim janë 12 veta, nuk marrim asnjë lloj shërbimi, ske numër regjistrimi të tokës, pse kur unë e kam marr me ligjin 7501, në Qark më figuron, në zyrën e Kadastrës nuk më figuron. Sjam vetëm unë, janë shumë atje, ka dhe Strumi, Arapaj, edhe Suk 1 se kam pyetur. Këshilli të marri një vendim të na i zgjidhi këto gjëra. Vjen nafta ne smarrim, mbjellim grur smarrim asnjë lloj investimi. Kryetari-të falenderoj z.Kryetar për shqetësimin e drejtë që ke sjellë këtu. Maksi-dua të falenderoj të gjithë pjesmarrësit, por veçanërisht këshilltarët. Kemi punuar bashkë në 2024, kemi kaluar shumë vendime në shërbim të komunitetit, ju falenderoj tej mase për vendimmarrjen e sotme e cila do të shërbejë për 2025, me qëllim që të jetë sa më afër qytetarëve të Bashkisë Roskovec. I uroj çdo familje tuajës fundvit të mbarë, festa të gëzuara dhe një vit sa më i mbarë për 2025. Kryetari-në përmbyllje të kësaj mbledhje do doja të falenderoja të gjithë ata këshilltar që në përgjigje të besimit që kanë marr nga votuesit e tyre, kanë qëndruar deri në fund të mbledhjeve, kanë qënë të fortë në argumenta, në vendimet që kanë marr në këtë Këshill të nderuar. Ju uroj të gjithëve nga zemra më të mirat për festat e këtij fundviti, përfitoj nga rasti të uroj edhe gjithë qytetarët e Bashkisë Roskovec. Mbledhjen e deklarojë të mbyllur.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Afrim Plaka

